


Nënkalimi i ri rrugor që lidhet me autostradën 'Princes Hwy-Lonsdale Street.' Vizatimi i piktorit. Mund të ndryshohet.



## ALBANIAN

Webster Street, Dandenong, gusht 2024

# Ndërtimi i një rruge të re për Dandenongun

Ne po heqim kalimin në nivel, duke mbyllur rrugën Webster në vendkalimin e nivelit (hekurudhorë) dhe do ndërtojmë një rruge të re nën linjën hekurudhore, kështu duke lidhur autostradën Princes Hwy – Lonsdale Street me rrugët Cheltenham dhe Hammond.

Nënkalimi i ri rrugor do të ridrejtojë trafikun larg nga qendra e biznezit të Dandenongut dhe do sigurojë që automjetet e renda të mos përdorin rrugen 'Webster Street.'

Heqja e këtij kalimi në nivel do të ofrojë një rrjet rrugor më të saktë me lidhje më të mira dhe kohë udhëtimesh më të shpejtë.

Gjithashtu do të përmirësojë sigurinë për shoferët, këmbësorët dhe ngasësit e bicikletave dhe do të mbështesë zhvillimin e ardhshëm në zone.

Dizajnat përfundimtare do të publikohen dhe punimet e para do të fillojnë më vonë këtë vit.

**Ndërtimi është në rrugën e duhur për të filluar në 2025.**



## Pse duhet të hiqet ku vendkalim i nivelit të rrugës?

Afërsisht **10,000 automjete** kalojnë neper këtë kalim të hekurudhës çdo ditë



Trafiku pengohet, nga kalimi i trenave për gati **62 minuta** gjatë mëngjesit në kohën e pikut. (nga ora 7–9 para dite)



**22 raste të shhangjes** së një aksidenti për pak, që nga viti 2012.

Do mbyllim rrugën 'Webster Street' në rrugëkalimin e nivelit në 2025. Nënkalimi i ri rrugor do të hapet në vitin 2028.

Mbyllja e këtij kalimi në nivelin e rrugës do të ndihmojë në krijimin e linjave hekurudhore të lëvizjes së trenave nga Pakenham dhe Cranbourne të jenë pa trarët (boom gates) që zbresin parallel me hekurudhën për ndalim-kalimin e trafikut



**Dizajnat përfundimtare do të publikohen dhe punimet e para do të fillojne më vonë këtë vit.**



Regjistrohuni për të rejat e përditshmet në:  
[levelcrossings.vic.gov.au](http://levelcrossings.vic.gov.au)

**VICTORIA'S  
BIG BUILD**

# Ç'është e rëndësishme për ju?

Në nëntor dhe dhjetor të vitit të kaluar, ne i kërkuam banorëve të Dandenongut të ndajnë njohurinë e tyre rreth gjërave të rëndësishme, sfidat që hasin gjatë udhëtimeve në këtë zonë dhe komente mbi dizajnat e konceptit.

Ne morëm më shumë se 120 komente nepërmjet sondaheve në internet, sesioneve të informacionit të komunitetit dhe hartës sonë interactive.

Ne dëgjuam se ulja e ngjeshjes së trafikut, ruajta e hapësirave të gjelbra dhe lidhjet më të mira të transportit aktiv, janë priorititetet e tuaja kryesore.



## Pakësimi i ngjeshjes së trafikut

Ju na thatë se do të dëshironit që dizajni të përmirësonë kushtet e trafiku dhe t'i lehtësonë udhëtimet nëpër zone.

Ju ndatë informacionin që kthesat e kufizuara dhe rritia e trafikut nga kalimi në nivel në autostradën 'Princes Hwy' – dhe rrugës 'Lonsdale Street; shkakton ngjeshje të trafikut.



## Lisa, bimësi dhe hapësira të gjelbra.

Banorët e zonës kanë dëshirë të shohin më shumë lisa, dhe bimësi të mbillet si pjesë e projektit. Binte në sy preferenca për mbjelljen e specieve vendase dhe autoktone.

Minimizimi i ndikimeve në lisat dhe vegjetacionin ekzistues është gjithashtu i rëndësishëm për komunitetin.



## Lidhje më të mira për këmbësorë dhe bicikleta.

Dëgjuam se do të dëshironit të shihnit lidhje më të mira për këmbësorët dhe ngasësit e bicikletave nëpër zonë.


Gjithashtu dëgjuam se aksesi lokal mund të përmirësohet duke lidhur shtigjet ekzistuese me dyqanet në zonë dhe stacionin e trenit të Dandenongut.



## Mësoni më shumë

Komentet tuaja së bashku me kërksat teknike do të formojnë dizajnat përfundimtare, të cilat do të publikohen më vonë këtë vit.

Skanoni kodin QR ose shikoni: [levelcrossings.vic.gov.au/webster-street](http://levelcrossings.vic.gov.au/webster-street) për ta lexuar raportin e konsultimit.



Trarët e ndalimit të trafikut në kryqëzim me hekurudhën, poshtë.

# Një nënkalim i ri që do lidhi Dandenongun

Jemi duke hequr trarët për ndalimin e trafikut (boom gates) të rrugës Webster duke mbyllur rrugën në kryqëzimin e nivelit dhe duke ndërtuar një nënkalim të ri rrugor që lidh aurostradën ‘Princes Hwy- Lonsdale Street’ me rrugët ‘Chelthenham Road’ dhe ‘Hammond.Road.’

Rugja e re nën hekurudhën do të pakësojë ngjeshjen e trafikut, ofron një rrjetë rrugor më mirë dhe përmirëson sigurinë.

Kur të hapet nënkalimi i ri, automjetet e rënda do të shmangen nga qendra e biznesit të Dandenongut dhe më pak makina do të udhëtojnë në rrugën Webster.

Me një kryqëzim të ri të sinjalizuar, shoferët që përdorin nënkalimin e ri do të mund të kthehen majtas dhe djathtas në autostradën ‘Princes Hwy- Lonsdale Street.’

Ne do e mbyllim rrugën Webster Street përgjithëmonë në kalimin në nivel, në vitin 2025 që do të thotë se automjetët nuk do të mund ta kalojnë më linjën hekurudhere.

Nënkalimi i ri rrugor do të hapet në vitin 2028.

Ne jemi duke punuar ngshtë me qeverinë dhe organet kryesore të transportit për të gjitha automjetet, duke përfshirë automjetet e rënda gjatë ndërtimit.

Më shumë informacion rreth devijimeve do të janë të disponueshëm përpara se të fillojë ndërtimi vitin e ardhshëm.

Shikoni dizajnat e konceptit dhe mësoni më shumë në faqën e internetit: [levelcrossings.vic.gov.au/webster-street](http://levelcrossings.vic.gov.au/webster-street)

*Harta si më poshtë. Pamje ajrore e rrugës së re nënkalimore. Vizatimi i piktorit. Mund të ndryshohet.*

## Përfitimet e projektit



Rrjet rrugor më të përshtatshëm




Ruga ‘Webster Street’ më e qetë e me më pak rreziqe



Të vazhdojë lëvizja e kamioneve dhe mallrave



Pakësim të ndërprerjeve të trenave gjatë ndërtimit



# Punime më të shpejta që do të fillojnë

## Ne do bëjmë hetime për të kuptuar më shumë rreth zones dhe se çfarë ndodhet nën tokë, nga shtatori deri në dhjetor.

Këtu përfshihen sondazhet e tokës, gjendja e rrugëve, dhe duke gjetur vendndodhjen dhe vlerësimin e shërbimeve nëntokësore në afersi të projektit. Ne do të përdorim këtë informacion për të informuar dizajnat finale dhe se si do ta ndërtojmë nënkalimin e ri.

Për më shumë informacion shikoni: [levelcrossings.vic.gov.au/webster-street](http://levelcrossings.vic.gov.au/webster-street)

## Po i afrohemë një linje hekurudhore pa pengesat shkaktuar nga kalimi i trenave, në nivelin e rrugës.

Kemi hequr 19 kalime në nivelin të rrugës dhe 3 të fundit në linjën hekurudhore Pakenham do të hiqen deri në vitin 2025. Gjithashu po e zgjashim linjën metropolitane deri në stacionin East Pakenham dhe do ndërtojmë edhe 9 stacione treni të tjera.

Krijimi i linjës të Pakenhamit pa pengesa kryqëzimesh të hekurudhës me rrugën në nivelin e rrugës, do ndryshojë mënyrën e jetesës për banorët zones ë; rreth punës dhe udhëtimit pa pengesa në nivelin e rrugës. Udhëtimet do të shpjetohen dhe rrugët në zone do të janë më të sigurta.

Mund të zbuloni informacione më shumë rreth projekteve që po ndodhin në linjën hekurudhore Pakenham në adresën: [bigbuild.vic.gov.au](http://bigbuild.vic.gov.au)



### Informacione të tjera

Për informacione të tjera dhe që të keni dijeni se ç'po ndodhë, regjistrohuni për lajmërimë të fundit në adresën: [levelcrossings.vic.gov.au/subscribe](http://levelcrossings.vic.gov.au/subscribe) si dhe nën 'Cranbourne-Pakenham Line,' zgjidhni **Webster Street, Dandenong**.

Shikoni: [levelcrossings.vic.gov.au/webster-street](http://levelcrossings.vic.gov.au/webster-street)

Telefononi: **1800 105 105** ose dërgoni email në: [contact@levelcrossings.vic.gov.au](mailto:contact@levelcrossings.vic.gov.au) në çdo kohë.

Na ndiqni në Facebook në: 'Level Crossing Removal Project. Mund të na dërgoni mesazh edhe në mënyrë private.

Për t'u regjistruar për SMS na dërgoni mesazh me shkrim në: **WEBSTER** tek numri cellular: **0428 581 917**.

*Imazhi më poshtë: automjete që presin në kalimin në nivelin e rrugës, në rrugën 'Webster Street.'*

### Koha e parashikuar për përfundimin e projektit –



**2018**

- Njoftimi i Projektit të heqjes së kalimeve në nivelin e rrugës.



**2022 deri nga fundi i vitit 2023**

- Hetimet e terrenit, hulumtimet e trafikut and planifikimi i punimeve.



**Nëntor 2023**

- publikimi i dizajnave të konceptit
- Konsultimi me komunitetin
- vazhdojnë hulumtimet e terrenit



**Nga fundi i vitit 2024**

- Publikimi final i dizajnave
- Fillimi i punimeve



**2025**

- Fillon ndërtimi
- Pengesat (trarë) tek kalimi i hekurudhës hiqen përfindimisht



**2026-2028**

- Ndërtimi



**2028**

- Hapet nënkalimi i rrugor

\* Kohëzgjatja mund të ndryshojë



[levelcrossings.vic.gov.au](http://levelcrossings.vic.gov.au)

contact@levelcrossings.vic.gov.au



Për gjuhë të tjera përveç anglishtes, ju lutem telefononi: 9209 0147

**1800 105 105**

(telefononi në çdo kohë)



Ju lutem na kontaktoni nëse e dëshironi këtë informacion në një format tjeter më të përshtatshëm. Nëse keni nevojë për ndihmë për arsyë të dëmtimit apo vështirësive të të dëgjuarit apo të folurit tuaj, shikoni: [relayservice.gov.au](http://relayservice.gov.au)

